



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 162, Datë 20.10.2020

**“MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT
PUBLIK TË AKTEVE TË MIRATUARA NGA ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË”.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16 dhe 18 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.109/6prot, datë 14.10.2020, të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, “Mbi miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 113, datë 09.07.2020 vendosi: Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë.
- ERE me shkresën nr. 62/19 prot, datë 13.07.2020, botoi në median e shkruar njoftimin mbi fillimin e procedurës për miratimin e kësaj Rregulloreje, duke ftuar të gjithë personat, shoqatat, institucionet, që mendojnë se kanë interes mbi këtë akt, të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim.
- ERE me shkresën nr. 996 prot, datë 22.07.2020, u kërkoi palëve të interesit të shprehnin opinionet dhe komentet, në lidhje me rregulloren e sipërcituar.
- Autoriteti i konkurrencës me anë të shkresës nr. 279/2 prot, datë 04.08.2020, shprehet se kjo rregullore nuk bie në kundërshtim me ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.
- Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me shkresën nr. 922/1 prot, datë 13.08.2020, ka shprehur opinionit e tij lidhur me miratimin e rregullores "Mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimin publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë", duke sugjeruar:

- Referenca ne Ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Zyra e komisionerit të shtohet edhe në nenin 1 të Rregullores. Ky propozim gjendet i drejte.
- Pas pikës 1 të nenit 6 të Rregullores, të shtohet edhe një pikë lidhur me publikimin e projekt akteve në faqen zyrtare online <https://www.konsultimipublik.gov.al/> të Regjistrimit elektronik për Njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK). RENJK është miratuar me vendimin nr. 828, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike", i cili është tashmë plotësisht funksional dhe shërben si pikë qendrore konsultimi.
- Në kuptim të parashikimeve të neni 4 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ERE është subjekt i kufizimeve nga detyrimi për publikimin.
- ERE merr vendime që përbëjnë akte nënligjore individuale ose akte nënligjore administrative. Vendimarrjet e ERE janë objekt i konsultimit publik për aq sa ligji për sektorin e energjisë elektrike dhe ai për gazin natyror parashikojnë, por nga ana tjetër mbështetur në sa spejguar më sipër, parashikimet e ligjit për konsultimin publik, ERE nuk ka detyrimin për publikimin dhe konsultimin e akteve të miratuara në kompetencë të ERE në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK).
- Per sa më sipër, vlerësohet e arsyeshme që pas pikës 1 të nenit 6 të Rregullores, të shtohet edhe një pikë si më poshtë:
 - Për aq sa është e mundur dhe e lejuar nga legjislacioni në fuqi, ERE do të marrë masat e nevojshme me qëllim publikimin e projekt akteve në faqen zyrtare online <https://www.konsultimipublik.gov.al/> të Regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK).
- Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996/5 prot, datë 28.08.2020, shpreh dakortësinë me përmbajtjen e saj.
- Kjo rregullore garanton një proces të drejtë dhe transparent ku të gjitha palët janë pjesë në konsultimin publik të akteve rregullatore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë(Bashkëlidhur).
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI

**RREGULLORE MBI PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK TË
AKTEVE TË MIRATUARA NGA ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat mbi organizimin e procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projekt-akteve që miratohen për kompetencë nga ERE sipas parashikimeve të ligjit nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar, ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

Neni 2

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga ERE, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

2. “Akt nënligjor normativ” është çdo vullnet i shprehur nga ERE, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron me zbatimin e tij.

3. “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

4. “Konsultim publik” është mbledhja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

“Njoftim publik” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar dhe nisja e procedurave të konsultimit publik.

5. “Organ publik” në kuptim të kësaj Rregulloreje është Enti Rregullator i Energjisë i cili është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar, ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”..

6. “Proces i vendimmarrjes” është proces që përfshin proceset e hartimit e të miratimit nga ERE të projektakteve.

7. “Projektakt” është projekti i një akti me interes të lartë publik, të hartuar nga ERE apo subjektet përgjegjës në kuptim të parashikimeve të Ligjit nr.43/2015 për sektorin e energjisë elektrike i ndryshuar apo ligjit nr.102/2015 për sektorin e gazit, ligjit 7/2017, miratimi i të cilit bëhet nga ERE.

8. “Regjistri elektronik” është faja zyrtare e internetit të ERE, ku do të publikohen projektaktet.

9. “Rekomandim” është çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara.

Miratuar me vendimin nr.162 datë 20.10.2020 të Bordit të ERE

10. “Seancë dëgjimore” është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga ERE në proceset vendimmarrëse të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

Neni 4

Kufizime

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e ligjit nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar, ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, sa i përket procedurës dhe afateve të parashikuara në të.

Neni 5

Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik

1. ERE do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

- a) publikimin në faqen e internetit të ERE të projektaktit dhe relacioni shpjegues mbi projektaktin.
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planit vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes së akteve normative;
- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

2. ERE, pas marrjes së vendimit të fillimit të procedurës për miratimin e një akti, si dhe publikimit të projektaktit në faqen e internetit të ERE, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe seanca dëgjimore me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar.

Neni 6

Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

1. Çdo projektakt që miratohet në kompetencë të ERE publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik në faqen zyrtare të internetit të ERE.

2. Për aq sa është e mundur dhe e lejuar nga legjislacioni në fuqi, ERE do të marrë masat e nevojshme me qëllim publikimin e projekt akteve në faqen zyrtare online <https://www.konsultimipublik.gov.al/> të Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK).

Miratuar me vendimin nr.162 datë 20.10.2020 të Bordit të ERE

Neni 7

Palët e interesuara

1. Palët e interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë:
 - a) organet publike që kanë interes mbi vendimmarrjen e ERE për shkak të fushës së kompetencës;
 - b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
 - c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Të drejtat e palëve të interesuara

- Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:
- a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt.
 - b) të përcjellin në ERE brenda afateve të parashikuara, komente dhe sugjerime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Neni 9

Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik

ERE cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj si dhe detyrimeve për hartimin e dokumentave dhe raportit që publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE. .

Neni 10

Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve

1. Njoftimi në faqen zyrtare të ERE për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet
 - a. Njoftimit për organizimin e seancës publike në faqen zyrtare të ERE
 - b. nëpërmjet regjistrimit elektronik
 - c. nëpërmjet botimit të projektaktit në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar
 - d. Me njoftimin nëpërmjet postës tek palët e interesit, të projektaktit dhe ftesës për komente apo opinione.

Neni 11

Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:
 - a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
 - b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
 - c) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur ERE vendos për organizimin e tij.

Miratuar me vendimin nr.162 datë 20.10.2020 të Bordit të ERE

Neni 12

Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

1. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë ERE komentet dhe rekomandimet e tyre brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.
2. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, ERE mund të zgjasë deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit, këtë afat.
3. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk anashkalojnë afatet kohore të përcaktuara në legjislacionin për sektorin e energjisë, dhe në mungesë të parashikimeve për këto afate, prevalojnë afatet e parashikuara në këtë nen.

Neni 13

Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit

- ERE mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:
- a) nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përfuara;
 - b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar.
 - c) gjatë fazës së konsultimeve, kanë rezultuar propozime e komente të tilla në masë dhe formë, që ndryshojnë në një masë të madhe projektaktin.

Neni 14

Njoftimi për takime publike

Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në seanca dëgjimore publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara seancës publike.

Neni 15

Pjesëmarrja në seancat publike

1. Konsultimi në seanca publike është i hapur.
2. Përfaqësuesi i ERE, që drejton Seancën publike, në përputhje me rregullat e ERE, u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të shprehur mendimin e tyre për çështjet që diskutohen.
4. Në çdo takim publik rregjistrohet dhe mbahet procesverbal, i cili pasi zbardhet protokollohet.
5. Procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike sipas kërkesës së paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Neni 16

Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve

1. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të ERE, dhe i përcillen për trajtim strukturës përgjegjëse të ERE në varësi të fushës së kompetencës përcaktuar në strukturën organizative të ERE.
2. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga struktura/t përgjegjëse e ERE për hartimin e projektaktit, e/të cilat vendosin për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara.

Miratuar me vendimin nr.162 datë 20.10.2020 të Bordit të ERE

3. Projektaktet shoqërohen me një relacion të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë struktura përgjegjëse paraqet në relacion një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre.

Neni 17

Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

1. ERE do të hartojë dhe të publikojë raport vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga ERE përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e takimeve publike të organizuara.

2. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE.